



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.410/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me kryetarin e trupit gjykues, gjyqtarin Besnik Bislimaj, gjyqtarët porotë Ismet Këndusi dhe Shpresa Manxhuka, me zyrtaren juridike Merita Xharavina, në çështjen juridike të propozueses Y.Rr. nga Gjakova dhe propozuesit Sh.Zh. nga Gjakova, për shkak të zgjidhjes së martesës dhe besimit të fëmisë, pas mbajtjes së seancës jo publike për shqyrtimin kryesor të çështjes, të datës 03.07.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

SHKURORËZOHET me marrëveshje martesë në mes të propozueses Y.Rr. data e lindjes..., në Prishtinë, dhe propozuesit Sh.Zh., data e lindjes..., në Gjakovë, e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, me datë ..., e regjistruar sipas numrit rendor..., numri i referencës

FËMIJA i përbashkët e mitura B.Zh. nga Gjakova, data e lindjes..., i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës së sajë Y.Rr. nga Gjakova, ashtu që Detyrohet propozuesi Sh.Zh. nga Gjakova që t'ia njoh këtë të drejtë propozueses.

Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Propozuesit Y.Rr. dhe Sh.Zh., që të dy nga Gjakova, pranë kësaj Gjykate me datë 31.05.2019 kanë parashtruar propozimin për zgjidhjen e martesës me marrëveshje si dhe besimin e fëmijëve, duke theksuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datë ..., pranë Ofiqarisë së gjendjes civile në Gjakovë, palët ndërgjyqëse në fillim të martesës kishin raporte shumë të mira bashkëshortore, mirëpo, më pas ato raporte çrregullohen, pasi që grindjet ishin shndërruar në konflikte të cilat kishin marrë karakter të përhershëm, ashtu që jeta e përbashkët ishte bërë e padurueshme. Propozuesit kanë disa vite që jetojnë ndaras dhe as që kanë kontakt mes tyre, prandaj edhe rivendosja e saj është e pamundur. Nga kjo martesë çifti bashkëshortorë kanë vetëm një fëmijë dhe nuk presin që të kenë tjetër fëmijë të përbashkët në të ardhmen.

Në shqyrtimin kryesorë Propozuesi Sh.Zh. nga Gjakova, në ka deklaruar se: mbesim në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje pasi që, me propozuesen raportet bashkëshortore janë përkeqësuar dhe nuk ka mundësi që të njëjtat të riparohen, andaj, dhe kemi vendosur që martesën ta zgjidhim me marrëveshje. Nga kjo martesë e kemi një fëmijë për të cilin kemi

arritur marrëveshje me shkrim me propozuesen që fëmija i përbashkët e mitura B.Zh. nga Gjakova ti besohet, në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës biologjike. Gjithashtu i njëjti ka deklaruar se kërkoi që fëmija i mitur pa lejen time të mos del asnjëherë jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Sa i përket kontaktit e kemi rregulluar në procedurë jashtëgjyqësore. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se mbetem në tërësi pranë deklaramëve të cekura më lartë, konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore që kjo martesë të zgjidhet me marrëveshje, si dhe nga administrimi i provave përkatësisht marrëveshjes, është vërtetuar fakti se propozuesit janë marrë vesh që fëmija i mitur B.Zh. nga Gjakova ti besohet në ruajtje, edukim dhe mbajtje nënës së sajë këtu propozueses Y.Rr., ndërkaq sa i përket kontaktit personal të propozuesit me fëmijën e mitur, këtë çështje e kemi të rregulluar me marrëveshje jashtë gjyqësore dhe nuk ka nevojë gjykata ta vendos kontaktin personal, shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Në shqyrtimin kryesor, propozuesja Y.Rr. nga Gjakova, ka deklaruar se mbes në tërësi pranë propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, pasi janë plotësuar kushtet ligjore që kjo martesë të zgjidhet, meqenëse, raportet në mes të bashkëshortëve janë përkeqësuar dhe nuk presin që këto marrëdhënie të rregullohen, nga kjo martesë kemi një fëmijë për të cilin fëmijë kemi arritur marrëveshje me shkrim dhe të cilën e kemi nënshkruar që fëmija i mitur B.Zh. do ti besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës së saj biologjike. Sa i përket kontaktit e kemi rregulluar në procedurë jashtëgjyqësore dhe nuk ka nevojë që gjykata të vendosë në lidhje e kontaktin. Andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin do ta zgjidhë martesën me shkurorëzim dhe besim të fëmijës. Ndërsa në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike, andaj konsideroi se janë plotësuar kushtet ligjore që kjo martesë të zgjidhet me shkurorëzim, dhe meqenëse nga kjo martesë kemi vetëm një fëmijë dhe as që presim që të kemi në të ardhmen i propozoi gjykatës që martesën ta zgjidhë me shkurorëzim dhe besim të fëmisë. Propozuesja nuk i kërkoi shpenzimet procedurale.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurën e provave, Gjykata ka bërë shikimin dhe leximin e Certifikatës së martesës nr.të ref... me nr.rendor.. e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë me datë 13.05.2019, leximi në certifikatën e lindjes për të miturën B.Zh., data e lindjes..., në Gjakovë, dhe numri serik të certifikatës ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë me dt.03.04.2019 dhe leximi në marrëveshjen për besimin e fëmijës i lidhur mes propozuesve me dt.16.04.2019.

Duke vlerësuar me kujdes dhe ndërgjegjeje e çmon secilën provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata gjeti se propozimi i përbashkët për shkurorëzim i propozuesve është **i bazuar**.

Nga leximi i certifikatës së martesës me nr.të ref... me nr.rendor ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë me datë 13.05.2019, gjykata ka vërtetuar faktin e lidhjes së martesës në mes të propozuesve Y.Rr. nga Gjakova, e lindur Rr., data e lindjes..., në Prishtinë dhe Sh.Zh. nga Gjakova, data e lindjes...

Nga leximi në certifikatën e lindjes për të miturën B.Zh., të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile me dt.03.04.2019 me numër serik ..., gjykata ka vërtetuar faktin e lindjes së fëmijës së mitur B.Zh. nga Gjakova, data e lindjes..., nga Babai Sh.Zh. dhe e ëma Y.Rr. që të dy nga Gjakova.

Nga leximi i marrëveshjes së lidhur me dt.16.04.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se propozuesit janë marrë vesh që fëmija i mitur B.Zh. nga Gjakova ti besohet në ruajtje, edukim dhe mbajtje propozueses Y.Rr. si nënë si dhe janë marrë vesh që babi të mbajë kontakte personale me fëmijën kur ai e shih të nevojshme dhe për këtë nuk do të ketë pengesa nga ana e propozueses.

Baza ligjore

Sipas nenit 68 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është e paraparë se *“martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës”* Me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se *“njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente”*. Me nenin 69 të LFK-së, parashihet se *“bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mesë tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër të jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe pa aftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dy anshme”*. Përfundimisht, me nenin 84 par.1 të LFK-së, parashihet se *“kur procedura ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me anë të marrëveshjes së dyanshme, faktet në të cilat është mbështetur propozimi nuk hetohen”*. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit 84 të LFK-së i cili parasheh që *“Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët gjykata mund t'i hetojë faktet dhe ta zbatojë procedurën e provave rreth pjesës së propozimit të bashkëshortëve që ka të bëjë me ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen financiare të fëmijëve, nëse bindet se propozimi i prindërve lidhur me këto çështje nuk ofron garanci të nevojshme se interesat e fëmijëve të tyre të mitur ose të paaftë me këtë marrëveshje do të mbrohen në masë të duhur”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje është i bazuar dhe se i njëjti duhet të aprovohet në tërësi si i bazuar. Gjukata vlerëson se mbi bazën e të lartcekurave, e duke u nisur nga fakti se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për prishjen e kësaj martese, vendosi sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, përkatësisht martesën e këtu propozuesve e zgjidhë me marrëveshje me nenin 69 të LFK-së. Kjo ngase më dispozitat e LFK-së, është e paraparë se martesa lidhet me vullnetin e të dy palëve, e po ashtu mbajtja e saj, është e varur po ashtu nga vullneti i të dy palëve. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është vërtetuar fakti se raportet në mes të propozuesve gjatë jetës së tyre të përbashkët janë çrregulluar deri në atë masë sa që jeta e ardhshme e përbashkët është bërë e pamundur, edhe pse bashkëshortët nuk jetojnë bashkarisht, të njëjtit kanë shkëputur çdo kontakt ndërmjet veti, nuk kanë dhe as që presin të kenë fëmijë. Siç edhe u cek më lartë, kjo edhe ka qenë arsyeja që në këtë çështje kontestimore, ndër të tjera, fare nuk është zhvilluar

procedura e tentimit të pajtimit të bashkëshorteve, e kjo duke u bazuar në nenin 76 par.1 pika (2) të LFK-së, andaj në bazë të të lartcekurave gjykata gjeti se propozimi i përbashkët i propozuesve është i bazuar dhe se i njëjti duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket besimit të fëmijëve, gjykata nga administrimi i provave ka vërtetuar faktin se palët ndërgjyqëse janë marrë vesh për besimin, mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve, me të cilën janë pajtuar që fëmija i mitur ti besohet në ruajtje, edukim dhe mbajtje nënës së sajë Y.Rr. nga Gjakova, e cila marrëveshje edhe për gjykatën është e pranueshme dhe në interes më të mirë për të miturën, pasi që qëndrimi i të miturës B.Zh. nga Gjakova me nënën e sajë është tejet me rendësi, duke pas parasysh moshën e të miturës si dhe lidhjet emocionale të sajë me nënën e sajë këtu propozuesen Y.Zh. nga Gjakova, andaj nga të gjitha këto të cekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimeve.

Gjykata nuk vendosi për kontaktet personale të propozuesit me fëmijën e mitur, pasi që bashkëshortët, këtë çështje e kishin rregulluar me marrëveshje jashtë gjyqësore në kuptim të nenit 145.1 të LFK-së.

Mbi bazën e të lartcekurave, e duke u nisur nga fakti se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, gjykata nuk i hetoi faktet sa i përket shkaqeve të zgjidhjes së kësaj martese, andaj edhe martesën e zgjidhi në pajtim me nenin 68 par.2 të LFK-së

Nga të lartë cekurat u vendos si më lartë, e konform nenit 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 68, 69 dhe neni 70 par. 2 të LFK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 457 të LPK-së.

GJYKATA THEMLORE NË GJAKOVË
C.nr.410/19, datë 03.07.2019

Sekretarja juridike:
Merita Xharavina

Kryetari i trupit gjyqës,
Besnik Bislímaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.